

Webinari i organizuar nga SIGMA/OECD me temë “Menaxhimi i Cilësisë për Institucionet Supreme të Auditimit”

13 prill 2023

Me datë 13 prill 2023, u zhvillua webinar i organizuar nga SIGMA/OECD me temë “Menaxhimi i Cilësisë për Institucionet Supreme të Auditimit”, ku pjesëmarrës ishin rrjeti i SAI-ve anëtare, Gjykata Evropiane e Audituesve dhe SIGMA.



Ky takim vjen në kuadër të punimeve të nisura nga Grupi i Punës së INTOSAI-t, i udhëhequr nga Gjykata Evropiane e Audituesve (ECA), e mbështetur nga Zyra e Auditimit të Mbretërisë së Bashkuar, i përbërë nga 25 anëtarë të 16 SAI-eve, të cilët do të rishikojnë Standardin ISSAI 140 – Menaxhimi i Cilësisë për SAI-et, për ta përshtatur me standardin ISQM (Standardi Ndërkombëtar për menaxhimin e Cilësisë). Në takim morën pjesë, përfaqësues të KLSH-së nga Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit

Profesional, znj. Aulona Jani, Drejtore, znj. Miranda Misini, Audituese e Parë dhe znj. Safete Pojane, Audituese e Parë.

Aktiviteti, i mundësuar nga SIGMA dhe mbështetur nga ECA së bashku me Zyrën e Auditimit të Suedisë, kishte për qëllim shqyrtimin e pritshmërive ndaj standardeve ndërkombëtare për një menaxhim efektiv të cilësisë përgjatë aktivitetit të një SAI. Gjatë webinarit gjithashtu u exploruan zhvillimet e fundit në standardet përkatëse, u diskutuan praktika të ndryshme si dhe u ndanë eksperiencat dhe sfida mes pjesëmarrësve.

Dr. Jenny Ohman, Drejtore e Auditimit në Zyren e Auditimit të Suedisë, diskutoi mbi rëndësinë që ka “cilësia” për SAI-et, pasi në momentin që një organizatë perceptohet se po ofron shërbime apo produkte me cilësi të diskutueshme, atëherë besimi tek organizata është i çënuar.

Diskutimin e vijoi Znj. Bogna Kuczynska, Drejtuese e Drejtorisë së Komitetit të Kontrollit të Cilësisë së Auditimit në ECA, e cila njëkohësisht udhëheq Grupin e Punës së INTOSAI-t për rishikimin e ISSAI 140. Znj. Kuczynska ofroi një shpjegim të vlefshëm mbi arsyet dhe objektivat e ndryshimit të ISSAI-140, duke u ndalur më gjatë në elementët e ndryshuar dhe kalimin nga kontrolli i cilësisë në menaxhimin e cilësisë.

Në vijim të këtij takimi pati edhe disa prezantime, të cilët ndanë eksperiencat e tyre sa i takon proceseve që lidhen dhe ndikojnë në kontrollin e cilësisë.

KLSH është përzgjedhur nga Iniciativa për Zhvillim e INTOSAI-t, për të qenë pjesë e projektit pilot “Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë” dhe pjesëmarrja në këtë takim shërbeu si një prolog drejt fillimit të këtij procesi të rëndësishëm, në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të cilësisë së aktivitetit auditues, njëkohësisht pjesë e objektivave strategjike të KLSH-së.